



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË

Nr 778 Prot

Ersekë më 10/02/2021

Lënda : Raporti i Njesisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2020.

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Bashkangjitur po ju dërgojmë "Raportin Vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm të vitit 2020 " bashkë me pasqyrat përkatëse.

KRYETARI

Erion

ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KOLONJË

**Raporti vjetor për veprimtarinë e
Auditimit të Brendshëm
për vitin 2020**

PËRMBATJA E LËNDËS

| | |
|---|-----------------|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | fq.3,4,5 |
| II. BAZA LIGJORE | fq.5-6 |
| III. ORGANIZIMI | fq.6-7 |
| III.1 MISIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM | |
| III.2 ORGANIZIMI I NJA | |
| IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIT TË BRENDSHËM..... | fq.7-10 |
| IV.1 ANALIZA E PROGRAMEVE TË AUDITIMIT PË PERIUDHËN RAPORTUESE | |
| IV.2. ANALIZA E MISIONEVE TË AUDITIMIT | |
| IV.3. FUSHAT ME RISK TË LARTË DHE TRAJTIMI TYRE | |
| IV.4 GJETJET KRYESORE SIPAS SISTEMEVE | |
| IV.5 VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM | |
| V. REKOMANDIMET..... | fq.11-12 |
| V.1. REKOMANDIMET E PROPOZUARA | |
| V.2 PËRGJIGJET DHE REAGIMET E MENAXHIMIT | |
| VI. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CLËSISË..... | fq.12 |
| VII. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE..... | fq.12 |
| VII.1 PROBLEME TË KONSTATUARA NËIDHJE ME FUNKSIONIMIN E AB | |
| VII.2 KAPACITET AUDITUESE | |
| VII.3 ZHVILLIMI I AFTËSIVE DHE NGRITJA E NIVELIT PROFESIONAL | |
| VIII. KONKLUZIONE | fq.13 |
| VIII.1 KONKLUZIONE MBI PROBLEMATIKËN E PUNËS AUDITUESE | |
| VIII.2 PRIORITET PËR VITIN E ARDHSHËM | |

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm paraqet rezultatet e arritura nga njësitë e auditimit në sektorin publik për vitin 2020, problemet më të rëndësishme të identifikuar dhe të trajtuara, ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korigjuese, si dhe sfidat dhe përpjekjet e pandërprera për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Ky raport paraqet nivelin e realizimit të programit të auditimit të brendshëm, trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale. Në këtë këndvështrim, raporti është në pajtueshmëri me kërkesën për përgjegjshmëri në lidhje me reformat e ndërmarra nga Qeveria në sektorin publik në Shqipëri.

Analiza e sistemit mbështetet në të dhënat e grumbulluara nga raportet periodike të njesise të auditimit të brendshëm, të ngritur në zbatim të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Kjo strukturë ka prezantuar rezultatet e veprimtarisë së saj gjatë vitit 2020, si dhe problematikat me të cilat ajo është përballur. Nga kjo njësi gjatë vitit 20 janë realizuar 4 mision auditimi të programuara.

Kjo situatë është ndikuar nga disa faktorë, ku përfshihen: kërkesat dhe vlerësim i ndryshëm i riskut për fusha të veçanta, dhe pasojat që ka sjellë , ndryshime ne nr e punonjesve te kesaj njesie.

Nga analiza e raporteve konstatohet se sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar një nivel të lartë risku përfshin, sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misionit të njesive publike, të cilat shfaqen me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe me mangësi në kuadrin rregullator e proçedural brenda vetë subjektit publik.

Njësia e auditimit të brendshëm që funksionon në sektorin publik ka kryer vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga ky vlerësim vërehet se ka raste të shumta që këto sisteme janë ngritur por janë vlerësuar me nivel të dobët ose nuk funksionojnë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

Nga ky vlerësim vihen re dobësi në procesin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik. Të gjitha këto kanë pasur ndikimet e tyre me pasoja financiare për buxhetin e shtetit. Nga auditimet e kryera janë konstatua 5 raste rast të shkeljeve financiare, për të cilat gjetjet llogariten në 528 mijë lekë.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara synojnë përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve. Rekomandimet janë në numër të konsiderueshëm gjithsej 59 të ndara në: rekomandime te përmirësimit te sistemit, rekomandime te karakterit organizativ 54 dhe rekomandime per arketime 5 rekomandime te tjera I.

Theksojmë se këto rekomandime kanë një nivel te ulet të pranimit, por niveli i zbatimit të këtyre rekomandimeve nuk mund të përcaktohet qartë. Procesi i zbatimit të rekomandimeve është në ndjekje të vazhdueshme si nga vetë subjektet ashtu dhe nga njësitë e auditimit të

brendshëm. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve siguron informacion jo vetëm për vlefshmërinë dhe dobishmërinë e auditimeve, por mundëson dhe vlerësimin e cilësisë të punës së auditit.

Në fund të vitit 2020 në sektorin publik funksionon 1 NJAB, në qeverisjen vendore, e cila ka planifikuar 3 auditues të brendshëm sipas organikes të miratuar nga keshilli bashkiak po qe realisht janë 2 punonjes pa funksion përgjegjesi.

Nga analiza e bërë, rezulton se në të gjithë sektorin publik kryet veprimtaria e tyre mbështetur ne ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, 1 NJAB e cila funksionon me nje pergjegjes dhe dy specialistë.

Një nga drejtimet ku duhet të fokusohet vëmendja e menaxhimit është ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i stafit të auditimit të brendshëm. Angazhimi i stafit me nivel të lartë profesionalizmi është një faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të ngritur në subjektin publike.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të pasqyruara në raportet e auditimit janë detajuar e analizuar në këtë raport, i cili përfshin një analizë të nivelit aktual dhe tregon zhvillimet e sistemit të auditimit të brendshëm përgjatë vitit 2020.

1.1 HYRJE

Funksioni i Auditimit të Brendshëm është një veprimtari e pavarur që mbështet menaxhimin e njësisë publike për arritjen e objektivave të saj, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe ritjen e përgjegjshmërisë. Njësia e auditimit të brendshëm e krijuar në zbatim të Ligjit 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ushtron veprimtarinë e saj audituese brenda njësisë publike.

Në këtë raport kryhet një analizë e hollësishme e punës së njësisë së auditimit të brendshëm mbi vlerësimin e kontrollit të brendshëm, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, proceseve të qeverisjes së subjektit publike etj. Këto vlerësime argumentohen dhe arsyetohen me përshkrimin e procedurave të ndjekuara të cilat kanë çuar në arritjen e këtyre opinioneve. Raporti përshkruan statusin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë së auditimit në sektorin publik, ai analizon procesin e planifikimit mbi bazë risku të përdorur gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm, mbi bazën e të cilit janë dhënë opinionet, përshkruan komunikimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e rezultateve, jep një kuadër të përgjithshëm të kufizimeve që kanë ndikuar në punën e auditimit të brendshëm si dhe pasqyron rezultatet më kryesore të kësaj veprimtarie në të gjithë sektorin publik.

1.2 Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të informojë Qeverinë vendore mbi veprimtarinë gjatë vitit 2020, të njësisë së auditimit të brendshëm që funksionon në institucionet e qeverisjes vendore.

Kërkesat gjithnjë e në rritje për një transparencë dhe përgjegjshmëri më të lartë mbi përdorimin e fondeve publike dhe monitorimin e tyre, nënvizon kërkesën për një fuqizim të funksionit të auditimit të brendshëm, i cili duhet të ushtrohet me kompetencë, profesionalizëm, ndershmëri e transparencë nga audituesit e brendshëm. Këtij qëllimi synojnë t'i shërbejnë dhe ndryshimet me të cilat përballemi dhe që duhet t'i japim zgjidhje optimale dhe të dobishme në të ardhmen.

1.3 Objektivat e Auditimit të Brendshëm

Në kuadrin e krijimit të një sistemi të auditimit të brendshëm publik në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare, të afër që t'i shërbejë kërkesave të një qeverisjeje të mirë, vihet në dukje si objektiv kryesor ofrimi i sigurisë objektive, të pavaruar, të arsyeshme dhe dhënien e këshillave për titullarin e njësisë publike, për përmirësimin e veprimtarsisë dhe për rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Meqënjëse veprimtaria e auditimit të brendshëm është e fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes, ajo jep siguri të arsyeshme nëse:

- Objektivat e përcaktuara në programet dhe planet e subjekteve do të arrihen;*
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;*
- Veprimtaria e subjekteve është në përputhshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe aktet nënligjore;*
- Informacionet e rëndësishme financiare janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;*
- Rekomandimet janë dhënë në mënyrë objektive dhe në kohë.*

1.4 Baza e të dhënave

Baza e të dhënave e këtij raporti është raporti përfundimtar i NJAB.

ILBAZA LIGJORE

- Ligji Nr.114/2015,datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
- Manuali i auditimit të brendshëm,miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100,datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- Ligji Nr.10296,datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",i ndryshuar me Ligjin Nr.110/2015,datë 15.10.2015.

- Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr8980, datë 15.07.2010.
- Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", datë 17.12.2015.

III. Organizimi

III.1 Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të japë siguri objektive dhe të pavarur, titullarit se:

- risqet kryesore që kërcënojnë realizimin e objektivave të Buxhetit janë identifikuar dhe mbahen nën kontroll;*
- strukturat në qendër dhe bazë menaxhojnë fondet sipas akteve ligjore, nën ligjore dhe akteve të tjera administrative të Buxhetit;*
- kontabiliteti prodhon raporte financiare të sakta;*
- në tërësi është ngritur dhe funksionon një sistem kontrolli funksional.*

Në sajë të realizimit të këtij misioni Përgjegjësi i Auditit realizon njëkohësisht një vlerë të shtuar në qeverisjen e Buxhetit.

Objekti i veprimtarisë është kryerja e auditimit të brendshëm të të gjitha strukturave, programeve, veprimtarive.

III.2 Organizimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm.

Profesioni që kanë audituesit e brendshëm përfshin jo vetëm vlerësimin e sistemeve të kontrollit por dhe dhënien e rekomandimeve, ata duhet të zotërojnë dhe të tregojnë se kanë nivelin e duhur profesional dhe integritet për të siguruar ushtrimin e drejtë dhe të saktë të funksionit të tyre. Për këtë qëllim, nga analiza e përbërjes së strukturave audituese konstatojmë se nga 3 auditues të brendshëm të planifikuar sipas organikave të miratuara, aktualisht janë të punësuar 2. Të dy audituesit janë të certifikuar si "Auditues i Brendshëm në sektorin publik".

IV. Rezultat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

IV.1 Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Programi i auditimit për vitin 2020 është mbështetur mbi planin strategjik. Përcaktimi i fushave me risk të lartë është hërë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin 2019.

Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur titullari e ka gjykuar të arsyeshme, janë kryer misione auditimi me urdhër të veçantë. Në subjekte në të cilat risku

është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Analiza e veprimtarisë tregon se shmangiet më të mëdha lidhen me llojet e auditimeve të kryera. Në lidhje me këtë kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

□ *Ndryshimi i prioriteteve në veprimtarinë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas);*

□ *Ndryshimi i regjistrit të riskut. Në ndryshimin e riskut u patën parasysh faktorë të cilët mund të shfaqeshin si rezultat i teknologjisë të përdorur në disa projekte informatizimi, etj. Faktorët e trajtuar më sipër janë marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor 2019-2022 nga NJAB dhe trajtimi i tyre synon minimizimin e impaktit negativ që ato kanë në ushtrimin normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë së tyre audituese.*

IV.2 Analiza e misioneve të AB

Misionet e auditimit të realizuara për shërbimin e sigurisë mbi bazë sistemi kanë qënë të plota, tematike dhe të tjera. Ato janë kryer në struktura vartëse të Njësisë publike dhe në subjekte të kontraktuara me Njësinë Publike. Të gjitha misionet e auditimit janë realizuar bazuar në:

- Manuali i auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
- Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr.8980, datë 15.07.2010.

Çdo ndryshim që i është bërë çdo misioni auditimi në drejtim të tematikës, afateve apo specialistëve është miratuar te titullari. Në fund të aktivitetit ka rezultuar një produkt vjetor ku përmbledhen dhënia e 59 rekomandimeve për masa organizative, 54- rekomandime te përmirësimit te sistemit, 5 rekomandime per arkitime dhe rekomandime te tjera .

IV.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Përcaktimi i fushave me risk të lartë është bërë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin 2020.. Në subjekte në të cilat risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Analiza e veprimtarisë tregon se shmangiet më të mëdha lidhen me llojet e auditimeve të kryera. Në lidhje me këtë kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas);

Ndryshimi i regjistrit të riskut. Në ndryshimin e riskut u patën parasysh faktorë të cilët mund të shfaqeshin si rezultat i teknologjisë të përdorur në disa projekte informatizimi, etj.

Faktorët e trajtuar më sipër janë marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor 2019-2022 nga NJAB dhe trajtimi i tyre synon minimizimin e impaktit negativ që ato kanë në ushtrimin normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë së tyre audituese.

IV.4. Risqet e identifikuar dhe trajtimi i tyre

Në Planin Strategjik dhe Vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm janë bërë përpjekje nga ana e audituesve të brendshëm për të identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e njësisë publike.

Gjatë ushtrimit të funksionit të auditimit të brendshëm në të gjithë aktivitetin e njësisë publike është përfshirë vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm, klasifikimi, mënyra e operimit dhe efektiviteti i tij. Ky drejtim i auditimit të brendshëm duhet vlerësuar dhe duhet parë me përparësi, për vetë faktin se mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm, ka sjellë pasojë prezencën e risqeve dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave strategjike të njësisë publike. Në njësinë tonë ku auditimi i brendshëm ka identifikuar dhe përcaktuar risqet kryesore, është informuar titullari i njësisë publike rreth fushave me risk ku ka nevojë të ndërmerren veprime të mëtejshme, si dhe është rekomanduar njësisia për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përcaktimin sa më të qartë të përgjegjësive, për të menaxhuar risqet me qëllim frenimin dhe minimizimin e tij, për një vlerësim të vazhdueshëm të riskut, për rishikimin dhe rishqyrtimin rregullisht të kontrolleve respektivë. Në të gjitha sistemet, të cilat janë vlerësuar me nivel të lartë risku, auditimi është parashikuar të kryhet me një frekuencë më të shpeshtë.

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër struktura audituese vlerëson me risk më të lartë sistemet në vijim:

Sistemi i prokurimeve si fusha ku risku është i lartë dhe më i pranishëm.

Sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misioneve të veçanta të institucionit konsiderohet si fusha ku risku i korrupsionit dhe mashtrimit është i pranishëm. Duke iu referuar të dhënave të Pasqyrës 3, bashkëngjitur këtij Raporti "Gjetjet sipas sistemeve".

Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit është vlerësuar me risk të mesëm por ka vijuar të jetë në fokus të objektivave të auditimit. Vlerësimet në këto sisteme kanë konsistuar jo vetëm thjesht në pajtueshmërinë me ligjet e rregullat por dhe vlerën e parasë së fondeve publike, pra në vlerësimin nëse fondet publike janë shpërndarë dhe përdorur për qëllimin që ato janë dhënë dhe deri në ç'masë është siguruar përdorimi i tyre me dobi, kursim dhe frytshmëri.

Sistemi i pagesave për personelin rezultoi të ketë një nivel të konsiderueshëm risku që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të procedurave ligjore të kërkuara për këtë qëllim. Vendosja e kontrolleve të pamjaftueshme dhe jo eficiente kanë sjellë rritjen e rasteve të shkeljeve dhe pagesave të parregullta për personelin e subjekteve publike.

Megjithatë, për subjekte të cilat janë konsideruar të kenë kompleksitet të lartë të veprimtarisë së tyre, vlerësimi i përgjithshëm i kontrollit të brendshëm ka çuar në gjykimin se niveli i riskut është i lartë, audituesit e brendshëm kanë kryer auditime të të gjithë sistemeve. Në raste të tjera auditimet kanë konsistuar në vlerësimin e sistemeve të veçanta të cilat janë vlerësuar të kenë dhe riskun më të lartë për periudhën.

Sikurse është përmendur më lart, përcaktimi i fushave me risk të lartë është bërë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin 2019. Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimi e ka gjykuar të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në planin vjetor, janë kryer misione auditimi me urdhër të veçantë të titullarit. Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

IV.5 Gjetjet kryesore sipas sistemeve.

Në ushtrimin e funksionit të saj, struktura e auditimit ka nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në fushën e investimeve publike, në fushën e prokurimeve, sistemin e pagave, ngritjen e strukturave dhe rekrutimin e AB etj, ku më kryesoret përmendim:

Në fushën e menaxhimit të fondeve dhe pasurive, investimeve publike ku vlerësimi i objekteve pas investimit nuk është bërë konform rregullave, apo veprime të tjera siç është kontabilizimi i veprimeve.

Shkelje janë konstatuar në sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, të cilat konsistojnë në gabime materiale në regjistrimin e transaksioneve të rëndësishme, shmangie nga standardet e miratuara, apo pasqyrim jo të saktë dhe korrekt të situatës financiare në deklaratat financiare.

Vërehet se nga auditimi i kryer janë konstatuar 5 raste të shkeljeve, për të cilat gjetjet llogariten në 528 mijë lekë.

IV.6. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga njësia e auditimit të brendshëm që funksionon në sektorin publik është kryer vlerësimi i kontrolleve të brendshme në njësisë publike që ka në juridiksion. Përgjithësisht, sistemet e kontrollit të brendshëm pranë subjektit të audituar, janë ngritur dhe vlerësohen në nivel të dobët dhe lind nevoja për përmirësime në menaxhimin ose në funksionimin e kësaj njësie publike. Si rrjedhojë e këtij vlerësimi paraqiten mangësi të dukshme në sisteme dhe fusha të ndryshme të funksionimit të njësisë publike.

Nga njësia e auditimit të brendshëm që funksionon në sektorin publik është kryer vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe vërehet se ka raste të shumta që këto sisteme janë ngritur por janë vlerësuar me nivel të dobët ose nuk funksionojnë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

Vihet re se sistemet e kontrollit të brendshëm të ngritura në njësinë publike kanë nevojë për përmirësime të dukshme me qëllim arritjen e rezultateve pozitive.

Nga auditimi i kryer nga NJAB, kryesisht gjatë auditimit të kryer në drejtorinë e Drejtoria e Ujësjetës Kanalizimeve, Drejtorinë e Parqeve dhe rekreacionit, Drejtorinë e shtëpive , Zyren e MZSh-se, Drejtorinë e Finances (Auditimi i Detyrimeve të prapambetura) është konstatuar sa më poshtë:

Nevoja e marrjes së iniciativave për ndryshime ligjore, kryesisht në lidhje me vlerat monetare;

Detyrime të prapambetura janë raportuar dhe ato detyrime që nuk plotësohen afatit ligjor për tu raportuar si të Tilla .

Nuk janë mbajtur kartela të vecanta për çdo detyrim të prapambetur.

Nevoja për vendosjen e hallkave shtesë të kontrolleve, përmirësimin e linjave të autorizimit dhe raportimit;

Përcaktim në mënyrë jo të drejtë e të saktë të detyrave, përgjegjesive dhe funksioneve të punonjësve në rregulloren e brendshme apo përshkrimin e vendit të punës, etj;

Moszbatim të rregullave ligjore dhe proceduriale për administrimin e vlerave materiale dhe monetare, ruajtjen e aseteve, kontabilizimin dhe regjistrimin e veprimeve në mbështetje të dokumentave mbështetës justifikues;

Kryerje të operacioneve financiare mbi bazën e autorizimeve e dokumentave justifikuese jo të plota;

Ushtrim të kontrollit jo rigoroz mbi zbatimin e procedurave operacionale në çdo hallkë të tij, etj;

V. Rekomandimet

Objektivi strategjik i auditimit të brendshëm nuk mund të arrihet plotësisht nëse do të synojë vetëm vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin e riskut dhe të qeverisjes vendore. Dhënia e rekomandimeve të zbatueshme dhe që i shtojnë vlerë subjektit të audituar është pjesa tjetër dhe shumë e rëndësishme e funksionit të auditimit të brendshëm, ç'ka është dhe misioni i këtij funksioni. Arritja e këtij objektiwi përcaktohet, në një masë të madhe, nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve.

Ndër rekomandimet më kryesore të dhëna nga NJAB mund të përmendim:

1. Rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efizienz i fondeve publike. Këto rekomandime synojnë në rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, vendosjen e rregullave të kujdesshme për parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes, ruajtjen e aseteve etj;
2. Rekomandime që lidhen me përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes të politikave, të procedurave dhe hartimit të strategjive të cilat e ndihmojnë njësinë publike për përcaktimin sa më real të prioriteteve dhe objektivave vjetore, afatmesëm dhe afatgjatë. Këto rekomandime synojnë në përmirësimin e veprimtarisë së strukturave vendimmarrës dhe këshillave drejtues dhe shpeshherë rishikimi i funksioneve të drejtuesve të nivelit të lartë dhe të mesëm të menaxhimit;

Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesin e subjektit të audituar, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien por dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pasiv, i cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve, që jo rrallë rezultojnë të paqarta dhe të paaplikueshme, atëherë nuk do të kishim përmbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjikë, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimtarisë së tij. Për këtë arsye, vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit nuk është kufizuar vetëm në paraqitjen e propozimeve për masa dhe rekomandimet e dhëna, por ka konsideruar si tregues të rëndësishëm dhe shkallën e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Informacion i detajuar mbi numrin e rekomandimeve të dhëna, të pranuar dhe të zbatuara për çdo institucion gjendet në pasqyrën 4, bashkëlidhur këtij raporti. Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Përpjekjet e auditimit për të përmirësuar punën në drejtim të zbatueshmërisë së rekomandimeve gjatë vitit 2020 reflektohen dhe në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve specifike për ndjekjen e rekomandimeve. Planifikimi dhe më pas kryerja e angazhimeve për të verifikuar ndjekjen e rekomandimeve ka ndikuar ndjeshëm për të siguruar informacionin mbi vazhdueshmërinë dhe vlerën e auditimeve. Për më tepër, praktika të tilla i shërbejnë dhe vetë punës së audituesve pasi zbatimi i rekomandimeve dhe vlera e tyre shërbejnë dhe si matës i performancës së veprimtarisë audituese.

VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë.

Sigurimi i cilësisë së aktivitetit të auditimit ka qënë një prioritet i punës për vitin që kaloi. Për këtë është punuar që me hartimin e planit vjetor, programit të auditimit, ndarjes së detyrave në mes specialistëve, rritjes së aftësive të tyre për të punuar në grup duke mos iu larguar përgjegjësisë për rezultatet e secilit. Realizimi i bashkëpunimit me subjektet e audituara duke bërë ballafaqimet për gjetjet, rishikimi i brendshëm i punës audituese përmes përgjegjësit të grupit dhe pastaj përgjegjësit të cilësisë dhe titullarit kanë bërë të mundur rritjen e cilësisë së aktivitetit auditues.

VII. Analiza e kapaciteteve Audituese.

VII.1. Problemet e konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB.

Gjatë periudhës së auditimit nuk kemi pasur probleme në lidhje me funksionimin e NJAB-së.

VII.2. Kapaciteti auditues.

Në përbërje të sektorit të auditit të brendshëm në Bashkinë Kolonjë janë aktualisht 2 specialistë me arsim të lartë ekonomik-financë. Niveli i tyre profesional është në arritje të larta.

Specialistët e sektorit të auditit janë të certifikuar si "Auditues i Brendshëm në sektorin publik".

VII.3 Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve

Gjatë periudhës raportuese të gjithë specialistët e auditit morën pjesë dhe kaluan me rezultate të mira Trajnimin e Vijueshëm të Detyrueshëm, i cili u organizua nga Njësia Qëndrore e Harmonizimit Për Auditimin e Brendshëm. Mendimi i gjithë specialistëve ishte se ky trajnim ishte organizuar mjaft mirë dhe përfitimi në ngritjen profesionale ishte i madh. Gjatë periudhës në fjalë nuk kemi kaluar në ndonjë trajnim ndërkomëtar.

VIII. Konkluzione.

VIII.1. Konkluzione mbi problematiken e punës audituese.

Nisar nga sa u tha më sipër nxjerrim këto konkluzione:

1. Buxheti i Bashkisë ka organizuar një sistem efikas të kontrollit të brendshëm përmes të cilit risqet identifikohen e monitorohen, gjë e cila ka sjellë një menaxhim financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e buxhetit duke dhënë një garanci të arsyeshme se fondet përdoren me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet. Ky sistem kërkon të përsoset në përputhje me objektivat e vitit në vazhdim të buxhetit.

2. Në buxhet është realizuar një veprimtari e pavarur audituese në sajë të së cilës është rritur frytshmëria e menaxhimit të riskut është përmisuar ndjeshëm sistemi i kontrollit të brendshëm dhe i qeverisjes së njësisë. Këto në sajë të realizimit të auditimeve në të gjitha strukturat e buxhetit nga ku janë gjeneruar rekomandime e masa që nga përmisimet në udhëzime, rregullore, në çështje të administrimit e deri në zhdëmtim të vlerave të keqpërdorura.

VIII.2 Prioritetet për vitin e ardhshëm.

Me gjithë arritjet ne shohim nevojën e përmisimit të punës për vitin që vjen në këto drejtime të cilat përbëjnë dhe prioritetet e këtij viti në aktivitetin auditues:

1. Rritja e efektivitetit të punës audituese nëpërmjet identifikimit të sistemeve më me risk të lartë, orientuar kryesisht në marrëdhëniet e buxhetit.
2. Përqendrimi i punës audituese në funksionimin e sistemeve të kontroleve kryesisht në strukturat bazë të buxhetit me qëllim që ato të bëhen më efikas.
3. Rritja e cilësisë së auditimeve përmes ngritjes profesionale të specialistëve në sajë të trajnimeve në vazhdimësi të tyre.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin !

Jemi në mirkuptim të çdo sugjerimi dhe kërkesë në adresë të njësisë sonë!

Per Njesine e Auditimit te Brendshem.

Fatos ZENELI (Sp Audit).

Illi Jarazi (sp Audit).



NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINE KOLONJE

Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2020

Nr numër

| Nr | Rekomandime të dhëna sipas prioritetit | Subjekte të Audituara | Statusi i Rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm | STATUSI I REKOMANDIMEVE | | | | |
|-----|---|-----------------------|---|-------------------------|------------------------------------|----------------------|-------------------|-------------------------|
| | | | | Rekomandim i dhënë | Rekomandim i pranuar nga Menaxhimi | Rekomandim i Zbatuar | Ne proces Zbatimi | Arsyetja e mos zbatimit |
| 1 | 2 | 3 | 4.1 | 4.2 | 4.3 | 4.4 | | |
| I | Rekomandime të përmirësimit të sistemeve | | | | | | | |
| I | Rekomandime të përmirësimit të kuadrin ligjor | | | | | | | |
| I | SHUMA 1 | | | | | | | |
| II | Rekomandime të karakterit organizativ | | 54 | | | | 54 | |
| I | SHUMA 2 | | | | | | | |
| III | Rekomandime për arketime | | 5 | | | | 5 | |
| | SHUMA 3 | | | | | | | |
| IV | Rekomandime të tjera | | | | | | | |
| | Shuma 4 | | | | | | | |
| | TOTALI (SHUMA 1+2+3+4) | | 59 | | | | 59 | |

PËR NJAB

III JARAZI

Fatos ZENELI



NUËSIA E AUDITIT TE BRENDSHËM NE BASHKINË KOLONJË

Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit per vitin 2020

000/le

| Nr | Subjekte te Audituar | GJETJET SIPAS FUSHES OSE SISTEMIT | | | | | | | | | | Shuma e dëmit ekonomik | | | |
|--------|---|-----------------------------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------------------------|--|-----|-----|
| | | 2.1 | 2.2 | 2.3 | 2.4 | 2.5 | 2.6 | 2.7 | 2.8 | 2.9 | 2.1 | | | | |
| a | 1 | Prokurim blerje & investime | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Drejtoria e Ujeshelles kanalizime | | | | | | | | | | | | | 274 | 274 |
| 2 | Drejtoria e Parqve dhe Rekreacionit | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 3 | Drejt Fir (Audit: Detyrim Praparhetura) | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| 4 | Drejtoria e Sherbimeve Publike | | | | | | | | | | | | | 182 | 182 |
| 5 | Repartit i MZSH | | | | | | | | | | | | | 72 | 72 |
| TOTALI | | | | | | | | | | | | | | 528 | 528 |

So Auditit

III JARAZI

Fatos ZENELI



NJËSIA E AUDITIT TË BRENDSHËM NE BASHKINË KOLONJË

Përmbledhse e përgjithshme të identifikuar sipas sistemeve për vitin 2020

Me numër:

| Nr | Subjekte të Audituar | GJETJET SIPAS FUSHES OSE SISTEMIT | | | | | | | | | | | | | Gjithsej |
|----|------------------------------------|-----------------------------------|--|--|-------------------------------------|-------------------------------------|---|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|----------|----|----|----|----------|
| | | 2.1 | 2.2 | 2.3 | 2.4 | 2.5 | 2.6 | 2.7 | 2.8 | 2.9 | 2.1 | 15 | 18 | | |
| 0 | 1 | Prokurim Blerje & investime | Sistemi i pagesave shpërblime e trajnime | Fonde e sig shoqëg Shëndetsore Përkj Shoqerore | Sisteme tatimeve taksave e doganave | Sistemet e administrimit te pronave | Sistemet e privatizimitshijes dhe giradheries | Sistemet e koncesioneve e ankandev | Sistemet e legalimeve urbanistike | Sistemet e kreditimit ,Subvendone | Te tjera | 1 | 1 | 9 | 10 |
| 1 | Drejtoria Ujeshelles Karalzim | | | | 1 | 2 | | | | | | | | 15 | 18 |
| 2 | Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacion | | | | | | | | | | | | | 16 | 16 |
| 3 | Auditimi i Detyrim te Prapambetura | | | | | | | | | | | | | 5 | 5 |
| 4 | Auditi i Drejtorise se Sherbimeve | | | | | | | | | | | | | 10 | 10 |
| 5 | Sektor i MZSH | | 1 | | | | | | | | | | | 9 | 10 |

59

PËR NJAB

III JARAZI

Fatos ZENELI



NËSISA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINE KOLONJE

Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2020

Në numër

| Nr | Rekomandime të dhëna sipas prioritetit | 1 | Subjekte të Audituara | 2 | Statusi i Rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm | 3 | STATUSI I REKOMANDIMEVE | | | | | | | |
|-----|---|---|-----------------------|---|---|---|-------------------------|-----|------------------------------------|-----|----------------------|-----|-------------------|-----|
| | | | | | | | Rekomandim i dhënë | 4.1 | Rekomandim i pranuar nga Menaxhimi | 4.2 | Rekomandim i Zbatuar | 4.3 | Në proces Zbatimi | 4.4 |
| I | Rekomandime të përmirësimit të sistemeve | | | | | | | | | | | | | |
| I | Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor | | | | | | | | | | | | | |
| I | SHUMA 1 | | | | | | | | | | | | | |
| II | Rekomandime të karakterit organizativ | | | | | | 54 | | | | | | 54 | |
| I | SHUMA 2 | | | | | | | | | | | | | |
| III | Rekomandime për arketime | | | | | | 5 | | | | | | 5 | |
| | SHUMA 3 | | | | | | | | | | | | | |
| IV | Rekomandime të tjera | | | | | | | | | | | | | |
| | Shuma 4 | | | | | | | | | | | | | |
| | TOTALI (SHUMA 1+2+3+4) | | | | | | 59 | | | | | | 59 | |

PËR NJAB

III JARAZI

Fatos ZENELI



Aneksi 3

PYETESORI VETVLERESIMIT PER NJESINE E AUDITIMIT TE BRENDSHËM

| Nr | PYETJET | REFERENCA LJGJORE | Arsyetim Mbi Vleresimin E Kryer | VLERESIMI | | | |
|--|--|---|--|-----------------------|--------------------------|-----------------------------|----------------------|
| | | | | Perputhshmeri e plote | Perputhshmeri e pjesshme | Perputhshmeri ne disa fusha | Mospërputhje e plote |
| TE DHENA TE PERGJITHSHME: | | Bashkia Kolonje | | | | | |
| Njesia Publike | | Bashkia Kolonje | | | | | |
| Emri Mbiemri I Drejtuesit të Njesise së Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe adresa e e-mail. | | | | | | | |
| Adresa e faqes së Internetit (ku gjendet I bashkangjitur organigrama e bashkise | | Bashkia Kolonjë gmail@.com | | | | | |
| Data e plotesimit (sipas protokollit | | 14/02/2020 | | | | | |
| Periudha e raportimit | | Viti 2020 | | | | | |
| Pershkrimi I pyetjeve te pyetesorit sipas kuadrit rregullator per Auditimin e Brendshëm. | | | | | | | |
| 1 | NjAB eshte ngritur ne perputhje me kerkesat e ligjit per Auditin e brendshem dhe Aktet nenligjore. | 1 Ligji Nr 114/2015 "Per auditimin e brendshem ne sektorin public " | V.K.B per miratimin e structures, Urdhri I kryetarit | 1 | | | |
| 2 | NjAB kryen aktivitetin ne Perputhje me kerkesat e ligjit Per auditin e brendshem dhe Manualin e Auditit te Brendshem (MAB) | 1 Ligji Nr 114/2015 2.Manuali I Auditimit te Brendshem(MAB) | Dokumantat e AB | 1 | | | |
| 3 | Karta e auditit te brendshem Eshte hartuar,miratuar dhe ploteson kerkesat e MAB .Ky document perditesohet ne rast te ndryshimeve te rendesishme ne kuadrin rregullator te njesise publike dhe auditimit te brendshem | 1.Neni 4 I ligjit Nr 114/2015 2.Manuali I Auditimit te Brendshem | Urdhri I kryetarit | 1 | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|--|--|---|--|--|--|
| 4 | NjAB eshte e pavarur nga ana funksionale, komunikon e paracjjet (kartern, planet dhe raportet) ne Komitetin e Auditimit te Brendshem (KAB) (nese ka) dhe i miraton tek titullari i njesise publike. | 1.Ligji nr.114/2015 2.VKM 160/2016"Per menyren e funksionimit, kompetencat dhe perberjen e Komitetit te Auditimit te Brendshem ne njesite publike". | | 1 | | | |
| 5 | NjAB eshte e pavarur nga ana funksionale, si dhe komunikon e raportin drejtperdrejt tek Titullari i Njesise Publike. | 1.Ligji nr.114/2015 2.Organigrama e njesise publike | Miratohen Raportet nga N /kryetarjBashki | 1 | | | |
| 6 | Audituesit e Brendshem kane akses te pakufizuar ne Dokumentacion, mjete dhe punonjes. | 1.Neni 15 i Ligjit nr. 114/2015 | | | | | |
| 7 | Audituesit e Brendshem jane te perfshire ne veprimtari te tjera operacionale pervec auditimit te brendshem | 1. Neni 17 i Ligjit nr. 114/2015 | | | | | |
| 8 | Drejtuessi i NjAB ndermerr nje proces te pershikallezuar te shqyrtimit te konflikteve te mundshme te interesit | 1. Neni 18 i Ligjit nr. 114/2015 | | | | | |

STRUKTURA ORGANIZATIVE E NJAB DHE KUALIFIKIMET E AUDITUESVE TE BRENDSHEM

| | | | | | | | |
|----|--|---|---|---|--|--|--|
| 9 | Struktura e Njab respekton Kerkesat ligjore(minimumi 1 Drejtues dhe 2 specialiste te auditimit te brendshem). | 1.VKM nr 83/2016 Per miratimin e kntereve te krijimit te njesive te auditimit te brendshem ne sektorin publik* 2.Organigrama e njesise publike | V.K.M Per miratimin e struktures se AB me punonjes. 2 specialiste. | 1 | | | |
| 10 | DrepuestiNJAB dhe audituesat e brendshem jane emeruar ne perputhje me kriteret e punesimit te percaktuara ne kuadrin rregullator | 1.Neni 11 i Ligjit nr 114/2015 2 Ligji nr.152/2013 3.Kodi i Punes | | 1 | | | |
| 11 | NjAB Permbush kerkesat ligjore per trainimin min e vijshem profesional | 1.Neni 20 i Ligjit 114/2015 | | 1 | | | |
| 12 | Veprimtaria e audituesve te NjAB eshte ne perputhje me Kodin e. Etikes se Audituesve te Brendshem. te miratuar nga Ministri i financave. | 1 Urdhen 86/2015 Per miratimin e Kodit te Etikes per Audituesit e Brendshem ne sektorin publik" | | 1 | | | |

PLANIFIKIMI DHE RAPORTIMI I VEPRIMTARISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM

| | | | | | | |
|-----|--|---|--|---|---|--|
| 13 | Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i NJAB shqyrtohet dhe vleresohet nga Komiteti i Auditimit te Brendshem (nese ka) dhe miratohet nga Titullari i Njesis Publike. | 1.Kapitulli III i MAB 2.VKM nr.160/2016 3.Proces verbal i mbledhjes se KAB | Plani strategjik dhe vjetor i miratuar me vendimin e Kryetarit | | | |
| 14 | Procesi i hartimit dhe miratimit te Planit Strategjik dhe Vjetor kryhet brenda afateve te percaktuara. Ky dokument dergohet zyrtarisht ne DHJAB | 1.Kapitulli III MAB 2.Nr. prot. date te planit strategjik dhe vjetor | Profesor kriteret dhe eshte derguar me shkrese percjellese. | 1 | | |
| 15 | Objektivat e Planit Strategjik dhe Vjetor te NJAB jane te percaktuara clartesisht dhe ne perputhje me objektivat e Njesis Publike. | 1.Kapitulli III MAB Programi Buxhetor Afatmesem i njesise publike. | Dokumentat e AB | 1 | | |
| 16 | NjAB mbulon me auditim te gjitha fushat/sistemet e njesise publike (njesi varesie dhe) drejtoese pjese e organigrames se njesise publike) duke i dhene prioritet fushave/sistemeve te perzgjedhura sipas nivelit te riskut (i larte, i mesem, i ulet). | 1.Plani strategjik dhe vjetor 2.Kapitulli III i MAB 3.Kuadri rregulator qe percakton fushat e pergjegjesise se njesise publike. | Dokumentat e AB | | | |
| 17 | Audituesit e Brendshem pershtateshmes, si dhe marrin ne konsiderate opinionem e ftullarit te njesise publike ne identifikimin e risqeve. Gjykimi i tyre eshte i pavarur dhe paanshem. | 1.Kapitulli III i MAB 2.Regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit te riskut te njesise publike | Dokumentat e AB. | 1 | | |
| 18 | Risqet qe lidhen me objektivat e njesise publike jane identifikuar dhe vleresuar drejt nga ana e Audituesve te brendshem | 1.Kapitulli III i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | |
| 19 | NjAB kontribon ne hartimin e regjistrit te riskut te njesise publike (nepermjet risqeve te vete NIAB-se dhe risqeve te regjle identifikuar gjate veprimtarise audituese) | 1.Ligji Nr. 10296/2010, i ndryshuar 2.Kapitulli III i MAB | | | 1 | |
| 20L | Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i pasqyron rezultatin e procesit te identifikimit dhe vleresimit te riskut. | 1.Kapitulli III i MAB 2.Plan strategjik dhe vjetor | Dokumentat e AB | 1 | | |

| | | | | | | | |
|----|---|---|-----------------|---|--|--|--|
| 21 | Burimet e nevojshme ft. NAB perlogariten dhe .hpermdahen ne mbeshtetje te objektivave. | 1.Kapitulli III i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 22 | Ndryshimet ne Planin Vjetor argumentohet,shyrtohen dhe vleresohen ng a Komiteti i Auditimit te Brendshem(nese ka),miratohen nga Titullari dhe jane pjese e dosjes.Kydokument degohet zyrtarisht ne DH/AB. | 1.Kapitulli III i MAB 2.VKM 160/2016 3.Proces verbal i mbledhjes se KAB 4.Nr. Prot te ndryshimit te planit | | 1 | | | |
| 23 | Angazhimet e auditimit kryhen sipas parashikimeve ne Planin Vjetor | 1.Kapitulli IV MAB 2.Raporti vjetor i veprintarise | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 24 | Fushveprimi dhe objektivat e programit te auditimit perfshijne vleresimin e sistemit te kontrollit te brendshem, nivelin e riskut dhe komponente te tjere. | 1.Kapitulli IV MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 25 | Programi i angazhim auditit hartohet nga grupi i auditimit dhe miratohet nga Drejtuesi i NJAB.Ky dokument respekton formen dhe permbajtjen sipas kerkesave te MAB. | 1.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 26 | Audituesit e Brendshem identifikojne sakte kontrollet qe minimizojne risqet,si dhe analizojne dhe vleresojne pershtashmerine e mjaftueshmerine e ketyre kontrolleve. | 1.Kapitulli III i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 27 | Gjate angazhimit te auditimit respektohen te gjitha fazat e percaktuara ne MAB. | I. Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 28 | Dosjet e auditimit administrojne evidencat e pershtateshme per te dokumentuar punen ne zbatim te program angaz him auditimit dhe per te mbeshtetur gjetjet. | 1. Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | |
| 29 | NAB ne rastet e kostsimit te parregullsive dhe veprimeve qe ne vleresimin e audituesve te brendshem perbejne veper penale,raporton menjehere tek Titullari i njesise publike, I cili informon strukturen e Inspektimit Financiar Publik | 1. Neni 14 te tiggjit 2. Nr.prot shkresa derguar inspektimit. | Dokumentat e AB | 1 | | | |

| | | | | | | | | |
|---|--|---|---|----|---|--|--|--|
| 30 | Cdo rekomandim i pasqyruar ne raport eshte i lidhur me gjetjet. | 1.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| 31 | Observacionet/kundershtite e subjektit te audituar te trajtohen ne raportin final dhe jane pjese e dosjes. | 1.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| 32 | Plani i Veprimit hartohet dhe miratohet nga Titulari i subjektit te audituar dhe dergohet ne NjAB brenda afatit te percaktuar. | 1.Neni 12 i ligjit 114/2015 2.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| 33 | NjAB Ndjek nje proces monitorimi te vazhdueshem lidhur me zbatimin e rekomandimeve te adresuara ne njesine publike. | 1.Neni 14 i ligjit 114/2015 2.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| 34 | Drejtuesi i NjAB paraqet analizen vjetore te veprimtarise tek Komiteti i AB (nese ka) dhe Titulari mbi qelimin, autoritetin, pergjegjesine dhe rezultatin e auditimit te brendshem ne raport me plann. | 1.Kapitulli i IV i MAB 2. VKM 160/2016 | Raportin e paraqit tek titullari dhe Ksh.Bashkiak se nuk ka Komitet i AB. | 1 | | | | |
| 35 | Procesi i hartimit dhe miratimit te raportit vjetor kryhet brenda afateve te percaktuara. Ky dokument dergohet zyrtarisht ne DH/AB. | 1.Neni 14 i ligjit 114/2015 2.Kapitulli i IV i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| RISHIKIMI I BRENDSHEM I CILESISE SE VEPRIMTARISE AUDITUESE | | | | | | | | |
| 36 | A ka Program te Sigurimit te Cilesise (indikatore te percaktuar per sigurimin e brendshem te cilesise) | 1.Kapitulli i VIII i MAB | Dokumentat e AB | | | | | |
| 37 | Rishikimi i brendshem i cilesise kryhet riga Drejtuesi i NjAB.Per MAB me strukture te paplotesuar rishikimi kryhet nga Drejtuesi i nje NjAB tjeter. Procesi dokumentohet | 1.Kapitulli i VII i MAB | | | | | | |
| 38 | Vleresimet/rekomandimet e procesit te rishikimit te brendshem te cilesise meren ne konsiderate per permiresimin e punes se NjAB dhe Jane pjese e doses se auditimit. | 1.Kapitulli i VII i MAB | Dokumentat e AB | 1 | | | | |
| 39 | Drejtuesi i NjAB raporton cdo tra tek titullari i njesise publike mbi rezultatet e vleresimit te brendshem te cilesise si mese e raportit vjetor. | 1.Kapitulli VII i MAB 2.Raport vjetor i veprimtarise | Dokumentat e AB | | | | | |
| DOKUMENTIMI I PUNES AUDITUESE | | | | | | | | |
| 40 | Dosjet e perhereshme/te perkoheshme platesojne kerkesat e MAB dhe al kivoohen sipas legjislacionit ne fuqi. | 1 Ligji nr 9154/2003 | Dokumentat e AB | | | | | |
| VLERESIMI TOTAL | | | | 37 | 3 | | | |